



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 08 Nëntor 2021

Nr: 113

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 74, TË PARAQITUR NË KQZ NË
DATËN 28.10.2021

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 08.11.2021 me pjesëmarrjen e:

| | | |
|----------------|---|---------|
| Elvis ÇEFA | - | Relator |
| Elvin LAKO | - | Anëtar |
| Ilijan RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli BELE | - | Anëtar |
| Ledio BRAHO | - | Anëtar |

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Instituti Shqiptar i Shkencave

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 74, datë 28.10.2021 depozituar nga Instituti Shqiptar i Shkencave, me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 457, datë 01.10.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës”

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;



vendimi nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pika 1, e nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin erregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Rrethanat e çështjes:

1. Më datë 28.10.2021, Instituti Shqiptar i Shkencave, organizatë jofitimprurëse e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.3048, datë 28.03.2011, ka paraqitur në Komisionin e Akimeve dhe Sanksioneve ankimin e regjistruar me nr.74 kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.457, datë 01.10.2021, duke kërkuar nga KAS-i:
 - A. *shfuqizimin e vendimit nr.457, datë 01.10.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim tek Komisioneri, ose*
 - B. *ndryshimin e vendimit nr.457, datë 01.10.2021, kryerjen e hetimit administrativ shtesë nga ana e KAS-it dhe marrjen e masave ligjore në përfundim të tij.*
2. Çështja objekt ankimi ka nisur me një denoncim të datës 31.05.2021 të Ankuesit drejtuar Komisionerit me objekt “keqpërdorim të parave publike në terrorin e Bashkisë Durrës, për favorizim të subjektit elektoral forca politike në pushtet (qendror dhe vendor) Partinë Socialiste, të kryer nga Këshilli i Ministrave dhe pushtetit vendor Durrës, përmes veprimeve zinxhir të përqendruara në datat e fushatës zgjedhore”.
3. Konkretisht, objekt i denoncimit ishin vendimet nr. 189 dhe 205 të Këshillit të Ministrave të datës 25.03.2021, si dhe vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës nr.43, datë 31.03.2021, nr.46, datë 14.04.2021, nr.50, datë 14.04.2021, nr.51, datë 14.04.2021 dhe nr.59, datë 20.04.2021, të cilat nga denoncuesi konsideroheshin si të dala në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe rregullat e KQZ-së që ndalojnë përdorimin e burimeve shtetërore në kohë fushate.
4. Lidhur me këtë denoncim të Institutit Shqiptar të Shkencave, Komisioneri mori vendimin nr. 457, datë 01.10.2021, me anën e të cilit shpalli moskompetencën për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara në denoncim.
5. Ankuesi ka parashtruar në ankim pretendimin se hetimi administrativ i kryer ka qenë i paplotë dhe se ankuesit i është cënuar e drejta për proces të rregullt ligjor, për shkak se ankuesi nuk është thirrur si palë e interesuar në procedimin administrativ, nuk është vënë në dijeni të



prapësimeve të subjekteve të denoncuar dhe se nuk është dëgjuar në përfundim të procesit të hetimit.

6. Lidhur me themelin ankuesi ka parashtruar pretendimin, se hetimi administrativ ka devijuar nga thelbi i denoncimit. Komisioneri ka konstatuar se nuk ka kompetencë të vlerësojë dëmin ekonomik që mund të jetë shkaktuar nga miratimi i listave të përfituesve, jashtë kushteve dhe kritereve ligjore, sikurse ka konstatuar se nuk ka kompetencë të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjëshmërinë e akteve të Këshillit të Ministrave apo vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës, dalë për zbatimin e tyre, në një kohë që ankuesi nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Ankuesi ka kërkuar që Komisioneri të çmojë nëse këto akte kanë dalë në kundërshtim me vendimin e Rregullatorit nr.09, datë 24.12.2020, si akte të miratuara në periudhën e ndalimit, apo jo.
7. KAS-i, pasi caktoi me short relatorin z. Elvis Çefa, vendosi të pranojë për shqyrtim ankimin dhe caktoi datën 08.11.2021 për shqyrtimin e tij. Në seancën e datës 08.11.2021, në praninë e përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, u paraqit, parashtrroi pretendimet dhe dha sqarimet e nevojshme përfaqësuesja e ankuesit, znj. Aranita Brahaj, Drejtore Ekzekutive e Institutit Shqiptar të Shkencave.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Instituti Shqiptar i Shkencave është organizatë jofitimprurëse, e cila ka në objektin e veprimtarisë së saj, ndër të tjera, monitorimin e “zbatimit të legjislacionit zgjedhor në Republikën e Shqipërisë dhe respektimin e standarteve ndërkombëtare për zgjedhjet në vend”. Neni 92/5 i Kodit Zgjedhor i njuh çdo subjekti të interesuar të drejtën për të paraqitur denoncime për “shkeljet e mundshme të këtij ligji nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët në lidhje me financimin e fushatës”. Shfrytëzimi i kësaj të drejte nga ana e Institutit Shqiptar të Shkencave e bën atë automatikisht “palë” në procedurën e hetimit administrativ të KQZ-së, në kuptim që i jep palës neni 33 i Kodit të Procedurave Administrative.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për të vendosur lidhur me denoncimet e paraqitura nga personat fizikë/juridikë, sikurse përcakton vendimi i Rregullatorit nr.9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat

dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

3. Hetimi administrativ, sikurse çdo procedurë administrative duhet të nisë me identifikimin e palëve, të cilat, si rregull, janë ato që vënë në lëvizje procedurën dhe ato kundër të cilave fillon procedura. Sipas KPrA, Komisioneri duhet që të jetë aktiv dhe i kujdesshëm në identifikimin e palëve në çdo procedurë hetimore që ai nis, sepse palët nuk janë vetëm ato që janë përcaktuar, por edhe ato që janë lehtësisht të përcaktueshme për shkak se “rezultati i procedurës administrative mund ta cenojë në të drejtat apo interesat e tyre të ligjshëm” (pika 3 e nenit 33 të KPrA). Në denoncimin e paraqitur nga ankuesi më datë 31.05.2021, kanë qenë palë lehtësisht të përcaktueshme, përveç denoncuesit, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave (pika 4 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.09, datë 24.12.2020 në bashkëveprim me pikën 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor), si dhe subjekti zgjedhor Partia Socialiste (pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor). Këto palë duhet të ishin njohur si të tilla, duhet të ishin vënë në dijeni për procedimin dhe duhet t’u ishin garantuar të gjitha të drejtat procesuale, sipas përcaktimeve të KPrA.
4. Nga shqyrtimi i ankesës, KAS-i del në konkluzionin se nuk ka ndodhur identifikimi i saktë dhe i rregullt i palëve të procedimit dhe se ankuesit nuk i është garantuar e drejta për t’u informuar për rezultatet e hetimit, nuk është dëgjuar dhe nuk i është dhënë mundësia që të shprehet në përfundim të hetimit administrativ. Palët e tjera nuk janë përfshirë fare, me cilësinë e palës, në proces.
5. KAS-i vendosi të pranojë kërkesën e ankuesit që KAS-i të kryejë hetimin administrativ i shtyrë nga nevoja e respektimit të parimit të eficiencës (neni 19 i KPrA), si dhe nga fakti se rrethanat e çështjes lejonin kryerjen e hetimit administrativ pa pasur nevojë për përfshirjen në procedurën e tij të palëve të interesuara, si dhe pa pasur nevojë për hetimin e mëtejshëm të fakteve dhe të pretendimeve të parashtruara.
6. Ankuesi konfirmoi përpara KAS-it se lënda e denoncimit/ankimit të tij ka lidhje vetëm me akte të Këshillit të Ministrave dhe marrëdhënies që ata krijojnë me ndalimin sipas dispozitës së nenit 3, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Ankuesi nuk pretendon të kundërshtojë vendimet nr. 189 dhe 205 të Këshillit të Ministrave të datës 25.03.2021, si dhe vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës nr.43, datë 31.03.2021, nr.46, datë 14.04.2021, nr.50, datë 14.04.2021, nr.51, datë 14.04.2021 dhe nr.59, datë 20.04.2021 si akte



që vijnë në kundërshtim me ligjin e buxhetit të shtetit, apo si akte që bien ndesh me legjislacionin në fuqi që rregullon riparimin e pasojave të tërmetit, sikurse nuk është qëllim i ankuesit që të kërkojë nga KQZ-ja të konstatojë nëse përgjatë zbatimit të akteve ka pasur abuzime me detyrën, apo jo. Shqyrtimi i çështjes nga këndvështrimi i ligjeve të tjera del jashtë sferës së hetimit administrativ të Komisionerit, për pasojë jashtë sferës së shqyrtimit administrativ nga ana e KAS-it.

7. Lidhur me analizën ligjore të dispozitës së pikës 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, KAS-i konfirmon qëndrimin e shprehur edhe në vendimet e tij të mëparshme, se ndalimi ka lidhje vetëm me:

- a) propozimin e akteve ligjore ose nënligjore,
 - b) miratimin e akteve ligjore ose nënligjore,
 - c) nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore në faqen zyrtare të institucionit miratues, me qëllim informimi të publikut në lidhje me vendimmarrjen e tij,
- vetëm në rast se aktet ligjore ose nënligjore parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë.

8. Dispozita e pikës 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020 ndalon propozimin, miratimin dhe nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore që parashikojnë dhënien e përfitimeve, por jo aktet zbatuese të këtyre akteve. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.189 dhe 205 të datës 25.03.2021 janë akte zbatuese. Akti që ka parashikuar dhënien e përfitimeve ka qenë ligji nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, i cili është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, sipas pikës 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020. Të njëjtin arsyetim ka shprehur KAS-i edhe në vendimin nr.86, datë 19.05.2021 (“miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021”). Po kështu, vendimi i KAS-it nr.88, datë 21.05.2021 ndjek të njëjtin arsyetim lidhur me një akt të këshillit Bashkiak Berat (“vendimi nr. 22, datë 29.03.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr. 60, datë 18.12.2019 të Këshillit Bashkiak Berat “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Beratit”, ka lidhje me afate dhe procedura. Ky vendim nuk sjell përfitime, nuk ul detyrimet, nuk fal taksat, por vetëm shtyn afatin, për një shkak ligjor të besueshëm dhe të justifikueshëm. Për këtë arsye, nuk formon shkelje në kuptim të pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor”).

9. Ankuesi ngriti në denoncim dhe gjatë hetimit administrativ pretendime lidhur me procesin e zbatimit të vendimeve objekt shqyrtimi dhe referoi tek “fakte” dhe “të dhëna” lidhur me përpilimin e listave të përfituesve, mënyrën e përfshirjes së individëve të caktuar në to, mungesën e emergjencës në trajtim etj., me qëllim që të provonte, sipas tij, se rasti nuk mund të përfshihej në fushën e përjashtimeve të parashikuara nga gjendja e fatkeqësisë natyrore.
10. KAS-i pranon konkluzionin e ankuesit se aktet e kundërshtuara prej tij nuk janë akte që përjashtohen nga ndalimi për shkak të kushtëzimit nga gjendje e fatkeqësisë natyrore, por nuk pranon analizën faktuale që e ka çuar ankuesin në këtë konkluzion. KAS-i çmon se analiza e “fakteve” dhe e “të dhënave” të servirura nga ankuesi është irrelevante për konkluzionin. Raporti midis ndalimit dhe përjashtimit, në kuptimin e dispozitës së pikës 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, është një raport vetëm kronologjik. Ndalimi nis në harkun e katër muajve para datës së zgjedhjeve dhe zgjat deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve, kurse përjashtimi ndodh vetëm nëse në ndërkohë verifikohet gjendja e fatkeqësisë natyrore apo e epidemisë/pandemisë. Verifikimi i rastit përjashtimor ndërpret ndalimin. Që dispozita të ketë kuptim duhet që shkak i përjashtimit (gjendje e fatkeqësisë natyrore ose epidemisë/pandemisë, zbatim i një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatim i një vendim gjyqësor të formës së prerë) të lindë pasi të ketë hyrë në fuqi ndalimi. Nëse ai ka lindur përpara ndalimit, atëherë edhe mund të zbatohet përpara se ndalimi të hyjë në fuqi.
11. KAS-i çmon se Komisioneri ka pasur detyrimin që të shprehej qartë dhe pa ekuivok lidhur me objektin e denoncimit. Hetimi i denoncimeve për akte ligjore dhe nënligjore të propozuara, miratuara apo nxjerra në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga pika 3 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020 dhe ndëshkimi i kundravajtësve është pjesë e detyrës dhe për të nuk duhet të shpallet moskompetencë.
12. KAS-i çmon përfundimisht se propozimi, miratimi dhe nxjerrja e VKM-ve nr.189 dhe nr.205, datë 25.03.2021, si dhe e vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës nr.43, datë 31.03.2021, nr.46, datë 14.04.2021, nr.50, datë 14.04.2021, nr.51, datë 14.04.2021 dhe nr.59, datë 20.04.2021 nuk vjen në kundërshtim me pikën 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, sepse këto akte nuk parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, por janë akte zbatuese të tyre. Për pasojë propozimi, miratimi dhe nxjerrja e tyre në periudhën e ndalimit nuk formon shkelje të kësaj dispozite.

13. Bazuar në këtë analizë ligjore, KAS-i çmon se Komisioneri, në përfundim të hetimit administrativ duhet të kishte vendosur pushimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës të subjektit ankues për kthimin e çështjes për rishqyrtim tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Pranimin e kërkesës për ndryshimin e vendimit nr. 457, datë 01.10.2021 të KSHZ dhe kryerjen e hetimit administrativ nga KAS.
3. Rrëzimin e kërkesës për vendosjen e sanksioneve për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
4. Ndryshimin e vendimit nr. 457, datë 01.10.2021 të KSHZ përse i përket shpalljes së moskompetencës së tij për shqyrtimin e denoncimit të ankuesit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 (ditëve), nga hyrja në fuqi.

Elvis ÇEFA - Relator (Kundër)

Elvin LAKO - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar (Kundër)



MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 74, datë 28.10.2021 depozituar nga Instituti Shqiptar i Shkencave, me objekt “Kundërshtimi i vendimit të KSHZ nr. 457, datë 01.10.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës”, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim.

1. Në vendimin objekt ankimi, KSHZ ka vlerësuar se denoncimi i bërë fillimisht nga subjekti ankimes është objekt shqyrtimi nga ana e tij dhe referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, KSHZ ka nisur hetimin administrativ për të arritur në përfundimin nëse kemi shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ nga ana e KAS, u konstatua se në procedurën e shqyrtimit administrativ të ndjekur nga KSHZ, nuk ishin thirrur si palë asnjë përfaqësues si nga Bashkia Durrës, ashtu edhe nga Këshilli i Ministrave, për të patur në këtë mënyrë mundësi të shprehnin qëndrimet dhe pretendimet e tyre. Sikurse edhe vetë anëtarët e shumicës në KAS e pranojnë se *“Në denoncimin e paraqitur nga ankuesi më datë 31.05.2021, kanë qenë palë lehtësisht të përcaktueshme, përveç denoncuesit, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave (pika 4 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.09, datë 24.12.2020 në bashkëveprim me pikën 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor), si dhe subjekti zgjedhor Partia Socialiste (pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor). Këto palë duhet të ishin njohur si të tilla, duhet të ishin vënë në dijeni për procedimin dhe duhet t’u ishin garantuar të gjitha të drejtat procedurale, sipas përcaktimeve të KPrA.”*. Referuar Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, palët kanë disa të drejta procedurale për të marrë pjesë në hetimin administrativ për të dhënë shpjegime për akuzat apo pretendimet e ngritura nga pala tjetër në kallëzimin e saj drejtuar KSHZ. Në këtë kontekst KAS ka konstatuar se asnjë nga palët kundrejt të cilëve është drejtuar denoncimi i ankuesit, nuk janë trajtuar si palë procedurale, duke u shkelur parimi i një procesi të rregullt ligjor.

2. Edhe më flagrant është qëndrimi i Komisionerit kundrejt vetë palës denoncuese Instituti Shqiptar i Shkencave, i cili gjithashtu nuk është thirrur si palë në procedim, madje nuk i janë vënë në dijeni as letërkëmbimet mes KSHZ dhe Bashkisë Durrës që janë administruar si prova në hetimin administrativ të KSHZ-së. Ndërkohë, sipas nenit 44 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative,



si palë e interesuar në procedimin administrativ ka të drejtë të marrë pjesë çdokush që ka interes të ligjshëm. Është e pakuptimtë kjo mënyrë të vepruari nga ana e KSHZ, kur është fakt i ditur botërisht se subjekti ankimues, shfaq një interes të ligjshëm në këtë procedim duke qenë njëkohësisht dhe kallëzuesi i denoncimit dhe për këtë arsye duhej thirrur domosdoshmërisht si palë e interesuar në procedimin administrativ të ndjekur nga KSHZ e për më tepër të ishte vënë në dijeni për çdo provë të administruar nga KSHZ në kuadër të hetimit administrativ të kryer prej tij pavarësisht rezultatit/vendimmarrjes së këtij hetimi.

3. Praktika e KAS tashmë është konsoliduar në mënyrën e trajtimit të ankimeve të kësaj natyre. Konkretisht nëpërmjet disa vendimmarrjeve të fundit të KAS dhe më konkretisht pas shqyrtimit të ankimeve të paraqitura nga subjekti organizata “Qëndresa Qytetare”, është konkluduar se KSHZ në trajtimin e ankimeve në të cilat pretendohen shkelje nga ana e institucioneve në zbatim të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, nuk duhet të mjaftohej vetëm me kërkimin zyrtarisht të informacionit lidhur me ngjarjen ndaj vetë institucionit i cili është denoncuar nga subjekti kërkues, por duhet të kryente një hetim të plotë e të gjithanshëm duke ftuar pikësëpari palët që kanë interesa të ligjshme që të jenë pjesë në procedim. Nëpërmjet këtyre vendimmarrjeve KAS, i cili në këtë fazë të procesit nuk ka marrë në analizë ligjshmërinë e argumenteve të KSHZ për sa i përket themelit të çështjes, ka konkluduar se respektimi i të drejtave dhe garancive procedurale të palëve pjesëmarrëse në procesin administrativ, ka rëndësi vendimtare për respektimin e procesit të rregullt ligjor. Këtë qëndrim KAS duhet të mbante edhe në rastin konkret.
4. Siç rezultoi nga hetimi administrativ i bërë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), ka një pasaktësi në konkluzionin e arritur nga ana e KSHZ në vendimin objekt ankimi se ai (KSHZ) nuk është kompetent të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimeve të marra nga Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Bashkiak Durrës. Siç edhe deklaroi në seancën publike të zhvilluar nga KAS, ankuesi nuk pretendon të kundërshtojë dhe të shfuqizojë në këtë procedim vendimet nr. 189 dhe 205 të Këshillit të Ministrave të datës 25.03.2021 apo vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 43, datë 31.03.2021, nr. 46, datë 14.04.2021, nr. 50, datë 14.04.2021, nr. 51, datë 14.04.2021 dhe nr. 59, datë 20.04.2021 si akte të kundërligjshme, por ai pretendon nga KSHZ që të konstatonte faktin se këto akte janë nxjerrë me qëllim për të favorizuar një subjekt të caktuar politik në garën elektorale për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, konkretisht Partinë Socialiste, dhe si të tilla janë në kundërshtim me vendimin nr.9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ. Në këtë kontekst, ishte detyrë e KSHZ të hetonte mbi të gjitha pretendimet e ngritura nga denoncuesi dhe në këtë mënyrë do të mund të ishte fokusuar drejt në kërkimet e tij.



5. Neni 81 pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative parashikon se “*organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji*”. Në rastin konkret rezulton se KSHZ është mjaftuar vetëm me shkëmbimin formal të korrespondencës me Bashkinë Durrës dhe Këshillin e Ministrave (i cili për më tepër nuk ka kthyer asnjë përgjigje), pa hetuar më tej me qëllimin për të mbledhur prova apo fakte që do të vërtetonte apo hidhte poshtë shkeljen ose jo të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Asnjë nga indiciet e dhëna nga ankimuesi, lidhur me procesin e zbatimit të vendimeve objekt shqyrtimi, lidhur me përpilimin e listave të përfituesve, mënyrën e përfshirjes së individëve të caktuar në to, mungesën e emergjencës në trajtim etj., pretendime të cilat i parashitroi edhe gjatë hetimit administrativ me qëllim që të provonte, se rasti nuk mund të përfshihej në fushën e përjashtimeve të parashikuara nga gjendja e fatkeqësisë natyrore, nuk ka marrë përgjigje nga KSHZ.

6. Në lidhje me themelin e shqyrtimit të kërkesës ankimore, ne anëtarët në pakicë të KAS, nuk ndajmë të njëjtin mendim me shumicën për sa i përket konkluzionit se miratimi dhe nxjerrja e VKM-ve si dhe e vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës nuk vjen në kundërshtim me pikën 3 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, sepse këto akte nuk parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, por janë akte zbatuese të akteve të tjera të mëparshme, sic është ligji për buxhetin, dhe për pasojë propozimi, miratimi dhe nxjerrja e tyre në periudhën e ndalimit nuk formon shkelje të kësaj dispozite.

7. Në vlerësimin tonë, ky konkluzion nuk mund të arrihet kurrsesi pa hetuar më parë në themel të gjitha pretendimet konkrete të ngritura nga ankimuesi në denoncimin e tij drejtuar KSHZ, si p.sh. miratimi i listave të përfituesve pa verifikuar statusin e tyre apo pretendimi që Këshilli i Ministrave nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim për sa i përket trajtimit të banorëve të qarqeve të tjera të prekura nga e njëjta fatkeqësi natyrore..., për të konkluduar, ashtu siç kërkon edhe ankimuesi, nëse ka apo jo abuzivizëm elektoral.

Ky hetim dhe kjo analizë bëhen akoma më të domosdoshëm edhe në konsideratë të faktit se rritja e madhe në shpërndarjen e granteve të programeve të rindërtimit dhe rritja e vlerës së shpërblimit për disa kategori përfituesish, janë gjetur si shkelje potenciale zgjedhore edhe nga Raporti Përfundimtar i ODHIR, duke rekomanduar hetime të mëtejshme nga organet e zbatimit të ligjit. Pavarësisht përmbajtjes së ankimit, si KSHZH, por dhe KAS, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të nenit 77 të K.Pr.Administrative që parashikojnë se “*1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe*

vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes” duhet të kryenin një hetim të thelluar për të arritur në rezultatin nëse Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo personi përgjegjës pranë Bashkisë/Këshillit Bashkiak Durrës ka kryer veprime në shkelje të nenit 91 të K.Zgjedhor apo rregullores përkatëse që është miratuar nga Komisioni Rregullator pranë KQZ-së në zbatim të nenit 91 të K.Zgjedhor.

8. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore nr. 74, datë 28.10.2021 duhet të ishte pranuar. KAS duhet të konstatonte se hetimi i kryer nga ana e KSHZ nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm, pasi nuk janë shteruar të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore për të siguruar provat dhe faktet e nevojshme për çështjen. Për këto arsye KAS, duke vlerësuar që KSHZ duhet t’u japë mundësinë palëve të njihen dhe të përballen me to, duhet të kishte vendosur:

- Shfuqizimi e vendimit nr. 457, datë 01.10.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës”.

- Riçeljen e hetimit administrative të plotë dhe të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke u garantuar të drejtat palëve në procesin administrative.

Elvis Çefa - **Relator**

Ledio Braho - **Anëtar**